

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ardian DVORANI</b>	- Kryesues
<b>Arjana FULLANI</b>	- Anëtar
<b>Evelina QIRJAKO</b>	- Anëtar
<b>Andi ÇELIKU</b>	- Anëtar
<b>Medi BICI</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretarja Ermelinda Kadiu, sot me datë 07.02.2017 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative që iu përket palëve:

**PADITËS:** **Gazment Koduzi**, përfaqësuar në gjyq nga Av. Artan Kodheli.  
**I PADITUR:** **Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë** (Në mungesë).  
**OBJEKTI:** Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës.  
**BAZA LIGJORE:** Nenet 143, 144, 145, e 155 i Kodit Punës.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë** me vendim nr. 88, datë 16.12.2013 ka vendosur: Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Gazment Koduzi.

Detyrimin e palës së paditur Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, që të dëmshpërblejë paditësin Gazment Koduzi me 2 (dy) paga mujore për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit, me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe me 2.5 (dy paga e gjysëm) mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Gjithsej 9.5 (nëntë paga e gjysëm) mujore me pagë bruto mujore 119.603 lekë.

**Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 440, datë 03.03.2014 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 88, datë 16.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në këtë mënyrë:

Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Gazment Koduzi.

Detyrimin e palës së paditur Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, që të dëmshpërblejë paditësin Gazment Koduzi me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit, me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe me 2.5 (dy paga e gjysëm) mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Me pagë bruto mujore 119.603 lekë.

**Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.**

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë:

### V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 440, datë 03.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

*U shpall në Tiranë, me datë 07.02.2017*  
**Nr.31001-01298-00-2015 Regj. Themeltar**  
**Nr.00-2017-56 Vendimi (28)**